

vendet imigruese, të organizohen vizita në vendlindjet e tyre, të jepen filma në gjuhën shqipe (të xhiruar te ne), të organizohen vizita të shoqatave kulturore e artistike dhe të ansambleve nga Kosova në vendet ku jetojnë shqiptarët, të hapen shkolla në gjuhën shqipe, të dërgohen në mënyrë të organizuar gazeta, revista dhe letërsi artistike në gjuhën shqipe, të shkruhet për ta më tepër në shtypin tonë etj.

Pjesa e katërt e botimit (555-648), në të cilën janë paraqitur 10 referate, i kushtohet formave dhe karakterit të bashkëpunimit të të mërguarve nga Jugosllavia, ku i prin referati i *Radoslav Rotkovićit*, Nga Kosova janë paraqitur dy autorë: *Pajazit*

Nushi me referatin *Karakterit dhe veçoritë e qasjes në studimin e mërgimit të kombeve dhe të kombësive të Krahinës së Kosovës dhe Ukshin Hoti* me referatin *Për komponentën klasore të politikës ndaj mërgatës*. P. Nushi shqyrton procesin e shpërnguljes së shqiptarëve, serbëve, malazezve dhe turqve nga Kosova, etapat e shpërnguljes (1912-1915, 1918-1941 dhe 1945-1971), shkaqet e shpërnguljes, faktorët shoqërorë që kanë ndikuar në koncentrimin e migrantëve (përkthësinë kombëtare, regionale, fetare dhe politike); autori jep gjithashtu edhe disa të dhëna për numrin e emigrantëve nga Krahina. Sa i përket bashkëpunimit ndërmjet të mërguarve të Kosovës, autori konstaton se ata „janë kryesisht jashtë lidhjes afatgjate dhe të organizuar me jetën dhe punën e kombeve dhe të kombësive të Kosovës dhe të tërë bashkësisë sonë” dhe nuk është koncipuar ndonjë program i gjithanshëm në këtë drejtim. Ukshin Hoti në referatin e përmendur trajton disa çështje shumë të rëndësishme

të mërgatës, duke u përpjekur të bëjë koncipimin e përkufizimit të fenomenit të mërgatës, pastaj ndalet në shpërnguljen, motivet e shpërnguljes, shtrirjen dhe numrin e migrantëve shqiptarë, strukturën shoqërore të të shpërngulurve etj.

Në fund të publikimit janë dhënë diskutimet (649-697), shtojcat (701-741), që përfshijnë referatin lidhur me veprimtarinë shkencore, humaniste dhe patriotike të Nikolla Tesllës, raportet e disa referateve në gjuhën angleze, rezymetë e fjalës hyrëse në disa gjuhë, sinopsisin dhe biografitë e autorëve.

Nuk ka dyshim se në këtë publikim janë ndriçuar së pari herë shumë aspekte të mërgatës së të gjitha kombeve dhe kombësive të Jugosllavisë. Mirëpo, duke pasur parasysh natyrën komplekse të mërgimit, shumë probleme nuk janë prekur fare ose nuk janë trajtuar sa duhet, bile sa i përket mërgimit të popullsisë së disa nacionaliteteve. Ndonëse të gjithë autorët, që janë të profileve të ndryshme (historianë, gjeografë, politikologë, juristë, ekonomistë etj.), kanë theksuar se kësaj problematike të ndërlikuar duhet kushtuar kujdes më të madh në të ardhmen, prapëseprapë nuk janë dhënë në fund të punës së këtij simpoziumi propozime dhe përfundime lidhur me aktivitetin konkret kërkimor, format e bashkëpunimit afatgjatë me mërgatën dhe organizatat e institucionet e tyre, mënyrën e ndikimit ndaj mërgatës etj. Megjithatë, ky publikim ka vlerë dhe rëndësi të madhe shkencore e profesionale, shoqërore dhe politike.

HIVZI ISLAMI

Zekeria Cana, LËVIZJA KOMBËTARE SHQIPTARE NË KOSOVË 1908-1912 Redaksia e botimeve e OPGBG „Rilindja”, Prishtinë 1979, 378

Për kah mosha dhe koha që merret me hulumtime në fushë të historisë, Zekeria Cana i përket gjeneratës së hershme të historiografëve të Kosovës. Është bashkëpunëtor shkencor i Institutit Albanologjik të Prishtinës dhe ka nis të merret me studime shkencore nga viti 1963. Nuk ka shkruar shumë. Më shumë i është kushtuar lapidarsimit të stilit vetanak dhe përsosjes së metodës së punës shkencore. Kjo është vu dukshëm në pah në veprën në shqyrtim.

Vepra *Lëvizja Kombëtare Shqiptare në Kosovë 1908-1912* është i pari studim

monografik te ne për lëvizjen kombëtare shqiptare në Kosovë në fazën e fundit të Rilindjes. Monografia shquhet me qartësinë e shkrimit, të gjuhës e të mendimeve dhe me thellësinë e trajtimit, veçmas të problematikës së sferës historiografike të lëvizjes kombëtare shqiptare dhe të asaj ndërkombëtare të periudhës që përkufizon tema, në gjirin e së cilës u zhvillua lëvizja kombëtare shqiptare. Bile, mu ky moment, të cilit gadi kryekreje i është kushtuar autori, këtë studim monografik e bënë të rëndësishëm, si të parin të tillë tek ne, midis një sërë monografish historiografike

mbi çështje të ndryshme të historisë së Kosovës.

Lënda në këtë monografi është sistematizuar në pesë krerë, kryesisht mbështetur në kthesat revolucionare më të rëndësishme në lëvizjen kombëtare në Kosovë në vitet 1908-1912: *Shqiptarët dhe revolucioni xhonturk* (27-56); *Qendresa kundër reaksionit xhonturk* (57-87); *Kryengritja e vitit 1910* (88-151); *Lufta për autonominë territoriale-administrative* (152-201); *Kryengritja e përgjithshme e vitit 1912* (202-281); *pastaj vijtë Përfundimi* (283-291); *Shtojcë materialesh arkivore* (292-333); *Rezymea në gjermanisht, Burimet e literatura, Treguesi i emrave të njerëzve dhe i emrave gjeografik dhe Pasqyra e ilustrimeve.*

Veprës i prin mendimi i D. Tucoviqit me të cilin ky mendimtar socialist i kundërvihej historiografisë borgjeze serbe: „Lëvizjet dhe luftërat e shqiptarëve nuk janë kryengritje 'njerëzish të egjër' kundër qytetërimit, siç i paraqesin disa, dhe as pjellë e gishtit dhe e qëllimeve të agjentëve të huaj, sikundër i prezentojnë të tjerët.” Nërkaq, studimi hapet me fotografinë e Hasan Prishtinës, sikur autori ia kushton atij veprën, të cilën edhe e mbyll po me një porosi të Hasan Prishtinës që ishte një si program për thellimin e luftës vetëmbrojtëse të popullit shqiptar mu në prag të Luftës ballkanike.

Në pjesën hyrse të librit jipet një vështrim kritik mbi historiografinë e përgjithshme dhe atë nacionale për problemin që është shtruar. Duke u mbështetur në literaturën jugosllave, angleze, frenge, ruse, gjermane e turke, stigmatizohet joobjektiviteti dhe njëanshmëria e historiografisë botërore ndaj historisë së fazës së fundit të Rilindjes Kombëtare Shqipëtare, të zhvilluar në vilajetin më kryengritës të Turqisë Evropiane — në Kosovë.

Duke bërë një analizë të literaturës historiografike shqiptare të para Luftës së dytë botërore, autori konstaton se edhe historiografia borgjeze shqiptare dha pak për këtë çështje sa të ndërlikuar po aq edhe të rëndësishme për historinë kombëtare shqiptare. Ai vuri në spikamë se as historiografia shqiptare, deri në fillim të viteve gjashtëdhjetë, nuk dha diçka të madhe për problematikën që trajtohet në këtë studim monografik.

Në vitet gjashtëdhjetë në Shqipëri dhe në Kosovë problematika e trajtuar në monografinë e Z. Canës është temë e një sërë studimesh e punimesh shkencore e të natyrës publicistike. Kjo është koha kur dijetarët shqiptarë i kthehen kësaj teme, e aktualizojnë hulumtimin e saj dhe nxjerrin përfundime të drejta shkencore. Zekeria Cana këtë temë e ka trajtuar në disa punime e studime të

botuara në revista të ndryshme historiografike. Ajo punë i shërbeu autorit për të sonduar terrenin, fushëveprimin në këtë lëmë, gjë që i siguroi rezultate të lakmueshme për kurorëzimin e vepërs.

Njohës, kritik e vlerësues i mirë i literaturës dhe i burimeve (veçmas të atyre të provincienses serbe), autori në këtë vepër monografike aq mirë i shkriu të dhënat e literaturës me ato të dokumenteve e të shtypit, sa që mendimi i tij rrjedh natyrshëm, pa shterzime të lindjes, lehtë, qetë, i pjekur. Kur do ta apostrofojë një dukuri, si poeti që përsërit refrenin, edhe ky e përsërit dhe e përforcon mendimin e shprehur më parë. I jep atij koloritet shprehës e forcë argumentuese. Kur themi kështu, nuk mendojmë se problematika që është trajtuar në këtë monografi do të mund të quhej çështje historiografike e zgjidhur plotësisht. Këtu vlerësojmë atë që është thënë dhe nuk akuzojmë për atë që ka mundësi të thuhet. Mirëpo, me këtë vepër të parë monografike të tij Z. Cana e verifikoi veten se i fle në zemër trajtimi i historisë diplomatike. Dhe, hiq vetëm disa fragmente nëpër kaptina, kjo vepër del si një përpjekje e mirë për një analizë (si e para ndër ne, në Kosovë) të historisë diplomatike shqiptare në fazën më të rëndësishme të lëvizjes kombëtare shqiptare.

Autori, në këtë vepër, aq sa i mundësuan burimet dhe literatura që e pati në dorë, e përcolli me vëmendje të përqendruar vargun e ngjarjeve historike të shteteve ballkanike e evropiane lidhur me çështjen shqiptare. Ai e përcolli idenë e lëvizjes, qëllimin e saj drejt pavarësisë, drejt lirisë kombëtare, pa e këputur atë, gjithmonë duke ia dhënë forcën natyrore që e kishte, që ajo, lëvizja, e arrinte me pjekurinë e saj.

Kështu, në këtë vepër, boshllëqet që mund t'i hetojë njohësi i literaturës dhe i burimeve, janë kryesisht të sferës së historisë së kulturës, të historisë ekonomike dhe të aksioneve luftarake. Këto pak boshllëqe kanë dalë si rrjedhim i faktit se autori, në rend të parë, u ka kushtuar kujdes të posaçëm çështjeve politike e diplomatike, por hetohet edhe mungesa e moskonsultimit të një sërë punimesh tona e të tjerëve të cilat flasin kryesisht për çështjet e historisë së kulturës shqiptare. Këto punime, në mos për asgjë tjetër, autorit do t'i kishin hyrë në punë ani mirë për faktologjinë e pasur dokumentare të tyre.

Veç kësaj, ndihet edhe mungesa e moskonsultimit të pjesës më të madhe të periodikut shqiptar të kohës, ose ngase vetëm pjesërisht ka shfrytëzuar shtypin zyrtar serb që dilte në Serbi ose në Perandorinë osmane. Nuk ka shfrytëzuar as të dhënat e shtypit evropian të këtyre viteve e veçmas është i pasur shtypi i

provinciensës gjermane. Për shkruarjen e një vepre si kjo, në mungesë të burimeve të provinciesës shqiptare bashkëkohëse me ngjarjen, është e domosdoshme edhe njohja e terrenit, e traditës historiografike popullore. Kjo i ka munguar në një masë të konsiderueshme librit në fjalë.

Në të mirë të një ribotimi e të një plotësimi të kësaj vepre, këtu e shohim të udhës të sjellim edhe ndonjë lëshim ose të metë të veprës, qofshin të natyrës metodologjike ose materiale e gjuhësore. Në shëmbëll të shembujve që sjellë vetë autori më mirë se ne do t'i hetojë lëshimet e tjera në vepër. Bie fjala në fq. 20-21 zihet ngoje I. Zherka si mbledhës i parë i kujtimeve historike në Kosovë. Vihet në spikamë se I. Zherka paska botuar në *Rilindja* punime publicistikohistorike, por nuk shenohet se në cilët numra. Po kështu, konstatohet se M. Pirraku paska botuar „një varg artikujsh” në *Rilindja, Fjala, Bota e Re, Jehona, Përparimi*, por nuk ipen as titujt e as numrat e revistave. Në fq. 355 ipet lista e shtypit të shfrytëzuar, me vitet që kanë dalur gazetat, por nga vetë teksti në vepër nuk shihet se po ai shtyp të jetë shfrytëzuar në masë të duhur, përpos *Radničke novine*.

Autori do t'ishte më mirë që Lumo Skendon (fq. 24) ta zënte ngoje me emrin e vërtetë — Midhat Frashëri. Mandej në fq. 92 është fotografia e nxënësve të *Idadisë* së Manastirit, kurse autori mendon se janë nxënës të *Idadisë* së Shkupit. Në fq. 95 thuhet se në Kongresin e dytë të Manastirit morën pjesë 40 klube. Ky kongres nuk punoi aq sa mendon autori (1-6 prill 1910) e as në kongres nuk morën pjesë 40 klube. Në kongres u morën edhe vendime të tjera. Puna e këtij kongresi shihet mirë në *Fjala* nr. 9/1968.

Me rastin e ndonjë ribotimi të kësaj vepre do kushtuar kujdes edhe emërtimeve gjeografike. Ka raste kur autorit i janë përvjedhur trajtat zyrtare serbe të emërtimeve si b. f. *Babin Most* (101) për *Babinoc, Gadimje* (124) për *Gadime, Rudnik* për *Runik, Černovran* për *Carravran* (127). Në disa vende ipet emërtimi *Arnautllëk*. Këtij emërtimi i duhet një shpjegim, përkatësisht, cilat vise i mbulonte emërtimi politik-gjeografik *Arnautllëk* — vendet me shqiptarë në përgjithësi apo vetëm viset e Vilajetit të Kosovës. Pra, këto të dytat.

Ndoshta do të mund t'i bëhej edhe ndonjë vërejtje në listën e emrave. Fjala vjen në fq. 363 shkruan: Bedri beu 118, 243, 303. Këtu janë përzjerë persona të ndryshëm nën një emër. Në numrin e parë e gjejmë Bedri be —

Ypin (shqiptar), nën të dytin Bedri beun komandant turk, kurse nën të tretin sikur nuk shohim asnjë Bedri be. Në disa vende bie në sy edhe ndonjë përsëritje tepër e theksuar si në fq. 112 e 143, kur flitet për Rustë Kabashin. Madje edhe as këmbëngulja e autorit që Rustë Kabashin ta tregojnë si tradhtar ndaj beslidhjesë dhe luftës së filluar të masave shqiptare të Kosovës nuk është aq bindës. Për këtë tezë duhet të punohet e gjurmohet edhe më. Nuk guxon të shkilet mbi traditën e në rend të parë kur Rrusta, ndër të vetmit, nga Carraleva „udhëtojë” për në Prizren ku e priste laku në fyt. Tradhëtinë e R. Kabashit do parë në tradhëtinë, ose më drejtë në punën e konfidentëve serbë në sherbim të Turqisë. Do parë edhe ndonjë paqartësi në tekst si b. f. në fq. 259 para fusnotave 166 dhe 167.

Edhe botimi i dy dokumentave: *Ditari i konsullit të Serbisë në Shkup Jovan Jovanoviqit* (292-316) dhe *Shkurtime të raporteve dhe të korespondencës së Ministrisë për çështjen shqiptare gjatë muajve të fundit* (24 qershor — 28 korrik 1911) më duket se e rëndon veprën. Te e fundit, dokumenti i parë është botuar qysh më 1969. Ndoshta ka qenë më e arsyeshme që gjatë shfrytëzimit të këtij dokumenti të tregohet, në nëntekst, në ndonjë gabim në botimin e parë. Ndërkaq, dokumenti i dytë, si material intern që ishte, më mirë t'ishte botuar gjetkë. Zatën, këtu, në këtë vepër, ai është vjelë aty ku është treguar i dobishëm.

Këto dhe të metat e tjera që mund t'i hetojë ndonjë studiues tjetër, të vetëdijshëm se nuk ka vepër pa asnjë të metë, nuk na ndalojnë të përmbylim se duke lexuar e studiuar veprën e Z. Canës *Lëvizja kombëtare shqiptare në Kosovë 1908-1912* më mirë se duke lexuar cilëndo vepër tjetër historiografike të botuar deri tash, do të mësojmë se në çfarë konditash është zhvilluar faza e fundit e lëvizjes kombëtare shqiptare, kurorëzimi i së cilës është bërë me aktin historik të pavarësisë së Shqipërisë.

Mirëpo, autori nuk e ka përfunduar në rrjedhë natyrore studimin. Mund të thomi se veprën të punuar shumë me seriozitet shkençor e ka lënë mu i mullarin e sanës të ngritur bukur por pa ia vu majën.

Kështu, sadoqë autori „etapën tjetër të luftës së armatosur për realizimin e pavarësisë shqiptare” e quan „Problem” që nuk është objekt trajtimi i kësaj monografie” e këputi me dhunë vargun e ngjarjeve historike: ushtarake, politike e diplomatike shqiptare, ballkanike e evropiane. Autori është dashur

të trajtonte më tutje problematikën në rrjedhë të ngjarjeve: Ç'ndodhi me fitoren sfidë shqiptare në Vijaletin e Kosovës mbi ushtrinë turke, të arritur deri në mesin e gushtit 1912? Përgjigjja në këtë pyetje e zgjidhja e kësaj çështjeje, mbi baza të materializmit dialektik mbetet pjesë vijuese përbërse e kaptinës *Kryengritja e përgjithshme e vitit 1912*. Bile

kjo kaptinë ndoshta më mirë do t'ishte të titullohej: *Kryengritja (ose lufta) për pavarësinë e Shqipërisë që pasohet pas Luftës për autonominë territoriale-administrative të Shqipërisë*. që pasohet pas *Luftës për autonominë territoriale-administrative të Shqipërisë*.

MUHAMET PIRRAKU

Mate Suić, ANTIČKI GRAD NA ISTOČNOM JADRANU, Sveučilišna naklada „Liber”, Zagreb 1976, 328.

Vepra e *Mate Suić* i t botuar në vitin 1976 për të cilën mund të thuhet se është një kontribut i çmueshëm për studimin e urbanizimit dhe të arkitekturës antike në vendin tonë dhe, siç thotë recensenti i kësaj vepre M. Prelog, është „një punë pionieri”. Libri është i ndarë në 7 kapituj dhe një suplement të veçantë, kurse teksti është ilustruar me 173 fotografi dhe vizatime si dhe 6 tabela.

Në parathënie autori thekson se kjo vepër nuk është historia e qyteteve tona në antikë dhe as historia e arkitekturës antike në bregdetin tonë, por kontribut për sqarimin e disa kapitujve nga kjo lëmë.

Pjesa e parë me titull *Oobjekti dhe metodat e hulumtimit* përfshinë sqarimet mbi kohën dhe territorin e studimit, paraqitjen e qytetit antik si qendër politike, ushtarake, ekonomike etj. Gjithashtu jep burimet për studimin e paleogjenezës, urbanizimit dhe vet urbanizimit të një treve si ato nga *Hekateu i Miletit*, *Pseudo-Skilaku*, *Pseudo-Skimnoja*, *Polibi*, *Livi*, *Straboni*, *Plini Plak*, *Ptolomeu*, *Anonimi i Ravenës* etj, të cilët në veprat e veta shënuan vendbanimet antike dhe komunikimin mes tyre. Autori tregon edhe vlerën e materialit epigrafik ku janë ruajtur të dhënat mbi situatën në qytetet e asaj kohe. Në vazhdim vijon inventari material i qyteteve antike nga faza protourbane dhe ajo urbane e bregdetit tonë, të dhënat mbi gjurmimet që u ndërmorën dhe rezultatet e tyre, si dhe klasifikimi i qyteteve në vendbanimet-qytetet me kontinuitet të pandërprerë, ata me kontinuitet të ndërprerë dhe vendbanimet pa kontinuitet. Pastaj jepet një pasqyrë e zhvillimit me rangje të qyteteve gjer në rangun e kolonisë romake. Në vazhdim autori paraqet regjistrin e qyteteve bregdetare në kohën pararomake si dhe në kohën e hershme romake sipas rangëzimit që e gëzonin ata. Kapitulli merr fund me pasqyrimin e rolit dhe kontributit të arkeologjisë, shkencave teknike, gjeografisë, linguistikës, sociologjisë,

historisë dhe shkencave të tjera në studimin e urbanizimit historik.

Kapitulli i dytë: *Prej fshatit autokton gjer te qyteti autokton-problemet e paleogjenezës*, përmban një pasqyrë të rrjedhës së konsolidimit historik të banorëve të bregdetit (Ilirëve dhe Protoilirëve) si dhe zanafillet e formimit të vendbanimeve (në bazë të lidhjeve fisnore), prej atyre më të thjeshta nëpër *vicus*-a, *pagus*-a prej të cilëve vazhdon zhvillimi i vendbanimeve në bazë të shthurjes së bashkësisë patriarkale. Tani zhvillohet bashkësia — *civitas*, që kishte si qendër *oppidum*-in. Gjatë kohës së ndikimit grek qytetet e bregdetit ruajtën pavarësinë, por duke i pranuar disa risi. Me ardhjen e romakëve këto u bënë pronë romake dhe në saje të këtij fakti në kohën e fundit të Republikës dhe fillimit të Perandorisë-kur u formuan ninitipet-ekzistonin tri lloj tokash: *ager publicus* (prona shtetërore), *ager privatus* (prona private) dhe *ager compascuus* (kullosat dhe pyjet), ndryshe nga sistemi ilir, ku nuk ekzistonte prona e tokave shtetërore, por vetëm ajo private dhe e përbashkët (kullosat dhe pyjet). Në vazhdim autori jep kriteret dhe kategorizimin e vendbanimeve të tipeve *gradina*, *refugium*, *castellum* dhe *oppidum*. Kapitulli mbyllet me trajtimin e çështjes së objekteve brenda vendbanimit, ku thuhet se ekziston mundësia që të ketë pasur shtëpi me plan (bazë) të rrumbullakët dhe jepet tipologjia e shtëpive me bazë katërkëndëshe (pararomake) prej tipit më të thejst me një dhomë gjer te ai me disa dhoma dhe objekte përcjellse të punuara prej guri ose druri, në disa raste edhe në teknikë të përzier. Autori vë në dukje se nga këto tipe u zhvilluan tipet e shtëpive në kohën romake. Gjithashtu në këtë pjesë trajtohet problemi i objekteve publike në vendbanime: shesheve (tregjeve), tempujve, rezervoarëve të ujit, komunikacionit urban si dhe rolit të tyre në sistemin më të vonshëm urban romak në bregdet.

Në kreun e tretë *Në agim të qytetit antik të botës klasike në Adriatikun lindor* bëhet